

LIGJ
Nr.7654, datë 24.12.1992

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7609, DATË 22.9.1992 "PËR TARIFAT
DOGANORE"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Neni 17 i ligjit nr.7609, datë 22.9.1992 "Për tarifat doganore" të ndryshohet si vijon:

"Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaktuar, që është çmimi i paguar ose që duhet të paguhet për mallrat, kur ato shiten për eksport drejt territorit doganor të Republikës së Shqipërisë. Vlera doganore përfshin çmimin e mallrave, shpenzimet e transportit dhe ato të sigurimit.

Kur organet doganore konstatojnë që çmimet e mallrave të importit të paraqitura në faturë, janë nën vlerat minimale të caktuara nga ministri i Financave dhe Ekonomisë, zbatojnë si vlerë doganore vlerat minimale për llogaritjen dhe nxjerrjen e taksave doganore.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë nxjerr vlerat minimale të mallrave të importit të pranueshme nga organet doganore.

Vlera doganore e mallrave të importuara apo eksportet përcaktohen në deklaratën doganore, kur mallrat kalojnë kufirin shqiptar".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.414, datë 8.1.1993, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.